REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 1209 prot. Tiranë, më 01.03.2021

**URDHËR**
**Nr. 102, Datë 01.03.2021**

# PËR MIRATIMIN E LISTËS SË EKSPERTËVE TË PAVARUR QË ANGAZHOHEN NË KRYERJEN E KONTROLLEVE TË VEPRIMTARISË SË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të pikës 8, të nenit 58, të Ligjit nr. 26/2019 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat", si dhe të pikës 9 të Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr.13, datë 17.07.2020 "Për miratimin e kritereve, procedurave të përzgjedhjes dhe shpërblimit të ekspertëve të jashtëm të pavarur, të cilët angazhohen në kryerjen e kontrolleve,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e listës së ekspertëve të pavarur që angazhohen në kryerjen e kontrolleve të veprimtarisë së përmbaruesve gjyqësorë privatë pranë Ministrisë së Drejtësisë, sipas Aneksit 1, bashkëlidhur këtij Urdhri.
2. Kjo listë është e vlefshme deri në miratimin e listës për vitin pasardhës, sipas përcaktimeve në Udhëzimin e Ministrit të Drejtësisë nr.13, datë 17.07.2020.
3. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë.
4. Lista e miratuar me ekspertët e pavarur për kryerjen e kontrolleve sipas aneksit 1 të këtij Urdhri, publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.
5. Ngarkohet Sektori i Arkiv Protokollit për marrjen e masave dhe njoftimin e këtij Urdhri Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë, Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, dhe ekspertëve të pavarur të miratuar sipas pikës 1 të këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**ETILDA GJONAJ (SALIU)**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E DREJTËSISË



Scanned with CamScanner

**ANEKS 1.**

## LISTA E EKSPERTËVE TË PAVARUR QË ANGAZHOHEN NË KRYERJEN E KONTROLLEVE TË VEPRIMTARISË SË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

| Nr. | Emër | Atësi | Mbiemër |
|---|---|---|---|
| 1 | ENTELA | RESHAT | NIKAJ |
| 2 | ILDA | IBRAHIM | DUHANXHIU |



Scanned with CamScanner